

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit M. G., nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson H. I., avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj, të cilin e përfaqëson me autorizim A. R., nga Ferizaj, për anulimin e vendimit dhe kthimin në vendin e punës, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.3152/2014 datë 5.9.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16.3.2017, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.3152/2014 datë 5.9.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AC.nr.3152/2014 datë 5.9.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore, Ferizaj, C.nr. 270/2010 datë 2.6.2014, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se janë të kundërligjshëm dhe të anulohen vendimi nr. 61 datë 16.4.2009 i Komisionit Disiplinor të të paditurës, vendimi i Drejtorisë së Administratës dhe Personelit të Komisionit të Ankesave të Komunës së Ferizajt 02 nr. 2/7/4781 datë 2.6.2009 dhe vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës A02 (137) 2009 datë 4.12.2009, si dhe të detyrohet e paditura QKMF-Shtëpia e Shëndetit Ferizaj, Shërbimi i Stomatologjisë, që paditësin në afat prej 7 ditësh ta kthejnë në vendin e punës së teknikut të dhëmbëve, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës. Me pjesën II të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i bart shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi me kohë ka paraqitur revizion për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale – neni 214 par. 1 pika (c) të LPK, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të ndryshohen ashtu që kërkesëpapia e paditësit të miratohet në tërësi si e bazuar, ose ato të prishen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se Komisioni disiplinor i QKMF, me vendimin nr. 226 datë 12.11.20108, paditësit i ka shqiptuar masën disiplinore ulje në pozitë (degradim). Komisioni i ankesave i Komunës së Ferizajt me vendimin nr. 02 nr. 244 datë 26.12.2008, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, paraqitur kundër vendimit për masën disiplinore të shqiptuar ndërsa Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës me vendimin A02 (75) 2009 datë 17.3.2009, ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar duke e lënë në fuqi vendimin e Komisionit për Ankesa. Drejtoria e Administratës dhe Personelit, Ferizaj, ka marrë konkluzionin 02 nr. 244 datë 22.1.2009, për ekzekutimin e vendimit të Komisionit, pasi që vendimi është bërë definitiv, në të cilin konkluzion është obliguar e paditura që paditësin ta caktojë në një vend pune me pozitë më të ulët, në përputhje me vendimin e Komisionit Disiplinor, ndërsa me pikën III të konkluzionit është caktuar se refuzimi i nënshkrimit të kontratës së punës konsiderohet heqje dorë prej marrëdhënies së punës. Paditësit i është ofruar kontrata e punës nr. 39 datë 23.1.2009, në pozitën e vozitësit në Sektorin QKMF-Shërbimi i autoambulancave dhe servisimi, por të njëjtën paditësi ka refuzuar ta nënshkruajë.

Me padi ka kërkuar që të anulohen vendimet e cekura si të kundërligjshme.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave ka gjetur se kërkesëpapia e paditësit është e pabazuar, ngase e paditura ka respektuar parimin e ligjshmërisë dhe ka zhvilluar procedurën disiplinore në përputhje me dispozitat ligjore të parapara me nenin 30 par. 1 të Urdhëresës Administrative nr. 2003/2 Mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, ka zbatuar drejt dispozitat materiale kur ka vendosur si në diapozitivin e

aktgjykimit, ndërsa nuk ka gjetur shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas pretendimeve të paraqitura në ankesë gjykata e shkallës së dytë nuk ka gjetur shkelje e as sipas shqyrtimit në bazë të nenit 194 të LPK, për të cilat ajo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, pastaj ka refuzuar ankesën si të pabazuar dhe aktgjykimin e ankimuar e ka vërtetuar.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët mbi gjendjen e vërtetuar faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë përmbajnë arsyet e mjaftuara për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejt të kësaj çështjeje juridike, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e paditësit të cekura në revizion se aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë janë marrë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale (nenin 214 par. 1 pika (c) të LPK), kjo ngase, mbi bazën faktike të vërtetuar në procedurën e gjykatës së shkallës së parë, gjykatat kanë zbatuar drejt të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, sepse me nenin 30.1 të Urdhëresës Administrative nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbyesit Civil të Kosovës janë paraparë shkeljet e sjelljes, dënimit dhe procedura disiplinore, ndërsa veprimet e të paditurës kanë qenë konform nenit të cekur dhe zbatimit të procedurave ligjore.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi pretendimin e cekur në revizion se për shkeljet e pretenduara të detyrave të punës për të cilat paditësi është fajësuar, ndaj tij me aktvendimin e Prokurorisë Publike Komunale në Ferizaj, PP.nr.618/2009 datë 27.1.2011, është hedhë kallëzimi penal dhe me asnjë provë nuk është vërtetuar se paditësi ka kryer ndonjë vepër penale, por kjo nuk ndikoi që kjo Gjykatë të merr vendim ndryshe nga gjykatat e instancës më të ulët, sepse paditësit marrëdhënia e punës i është ndërprerë pas refuzimit të nënshkrimit të kontratës së punës e cila i është ofruar si masë disiplinore ulje të gradës dhe njoftimit se mos nënshkrimi i kontratës konsiderohet heqje dorë nga marrëdhënia e punës. Paditësi ka mund ta vazhdojë marrëdhënien e punës sipas kontratës së cekur dhe të vazhdojë procedurën administrative për shfajësimin e tij, mirëpo i njëjti nuk e ka kundërshtuar vendimin kontestues pranë organeve kompetente gjyqësore.

Faktin se aktvendimi i Komisionit disiplinor nuk përmban pjesën e domosdoshme të sanksionit, për të cilën pozitë më të ulët është fjala dhe sanksionin e shqiptuar e bënë të pa ekzekutueshëm, Gjykata Supreme e Kosovës, e vlerësoi si të pabazuar, ngase grada e pozitës është përcaktuar në bazë të rregullave të paditurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, revizionin e shqyrton sipas nenit 215 të LPK, vetëm në pjesën e tij të goditur me anë të revizionit dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion. Kjo Gjykatë nuk gjeti se aktgjykimi i kundërshtuar është marrë me shkelje thelbësore për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare. Lidhur me shkeljen e të drejtës materiale paditësi nuk ka cekur asnjë nen konkret të ligjit material për të mbështetur pretendimin e tij se ku qëndron shkelja e ligjit material.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi edhe pretendimet tjera të revizionit lidhur me mos fajësinë e paditësit dhe analiza e secilit vendim të marrë nga e paditura dhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës, por të njëjtat pretendime kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, për të cilat në bazë të nenit 214 par. 2 të LPK, revizioni nuk mund të paraqitet.

Nga sa u tha më lartë e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr. 352/2016, më 16.3.2017

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku